

V E N D I M
“ NE EMER TE REPUBLIKES ”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE : KAÇE AGOLLI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Luljeta Kazia** , sot me **date 15.06.2012**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen penale me Nr. 1026 Akti qe i perket:

KERKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane

OBJEKTI: Vendosje Sekuestro

BAZA LIGJORE: Neni 210 i K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi dëgjoi shpjegimet e prokurores, administroi provat shkresore, degjoi ne pretendimet e fundit prokuroren e cila kerkoi pranimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi :

VEREN :

Gjate hetimit gjyqësor rezuloi se:

Në datë 24.04.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr. 1979 për veprën penale të “fallsifikimit te dokumentave” dhe “vjedhjes duke shperdoruar detyren” të parashikuar nga neni 186 dhe 135 i Kodit Penal.

Nga studimi i materialit kallezues rezulton se Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA) Sh.a ka bere kallezim penale ne ngarkim te ish punonjeses (.....). Kjo shtetase ka ushtruar detyren e specialistes ne sektorin e finances dhe kontabilitetit per mbajtjen e veprimeve te arkes dhe paradhenien e sherbimeve jashte shtetit per personelin. Kallezuesi pretendon se gjate ushtrimit te kesaj detyre , shtetasja (.....) ka pervetesuar nje shume totale prej (.....) euro ne menyre te kundraligjshme duke fallsifikuar dokumentat e personit juridik ANTA sha dhe konkretisht Ceqet me numrat (.....), (.....) dhe (.....).

Persa me siper per nevoja te hetimeve mbi kete procedim penale nga Organi i Prokurorise eshte e nevojshme marrja dhe administrimi ne dosje i dokumentave origjinale te ndodhur prane Bankes “Intesa San Paolo” me qellim identifikimin e personit qe ka paraqitur ceqet ne emer te ANTA Sha, identifikimin e shumes se terhequr si dhe identifikimin e personit qe ka bere terheqjen e parave.

Persa me siper, meqenese marrja e dokumentave te sipercitura eshte i nevojshem per vazhdimin e hetimeve dhe meqenese keto dokumenta ndodhen prane nje institucioni bankar,

ne referim te nenit 210 te Kodit te Procedures Penale, gjykata cmon se kerkesa eshte e drejte, e bazuar ne prova dhe ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata , bazuar ne nenin 210 te K.Pr.Penale

VENDOSI:

1.Vendosjen e sekuestros per dokumentat e poshtecituara :

1. Çeku me nr. (.....)qe mban daten 11.01.2011 paguar ne favor te (.....).
2. Çeku me nr. (.....) qe mban daten 01.07.2011 paguar ne favor te (.....).
3. Çeku me nr.(.....) qe mban daten 21.10.2011 paguar ne favor te (.....).
4. Praktika e plote dokumentare qe ka te beje me paraqitjen e çeqeve dhe terheqjen e shumave lidhur me keto çeqe.

2. Per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohet O.P.GJ prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane (.....).

3.Kunder ketij vendii lejohet ankim sipas ligjit.

4.U shpall sot ne Tirane date 15.06.2012

SEKRETARE
LULJETA KAZIA

GJYQTARE
KAÇE AGOLLI